

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: "SISTEMI I KOMUNIKIMIT NË DISTANCË PËR POLICINË BASHKIAKE".

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Pajisje komunikimi 32570000-9 • Paketa software për komunikim dhe multimedia 48500000-3.

VLERA E FONDIT LIMIT: 24.968.667 (njëzet e katër milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh, me objekt: "Sistemi i Komunikimit në distancë për Policinë Bashkiake", vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë me anë të V.K.B-së Nr. 126 dt 23.12.2022 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2023" i përbërë nga dy vlera që u përkasin dy llogarive të ndryshme, respektivisht llogarisë për investime dhe asaj për shpenzime korrente, si më poshtë vijon:

1. **"Sistemi i Komunikimit në distancë për Policinë Bashkiake",** në programin buxhetor "Investim (231)" me tipologji **"Hardware dhe software"** me vlerë të fondit limit 22.480.000 (njëzet e dy milion e katërqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.
2. **"Sistemi i Komunikimit në distancë për Policinë Bashkiake",** në programin buxhetor "Shpenzime operative (602)" me tipologji **"mirëmbajtje +trajnim"** me vlerë të fondit limit 2.488.667 (dy milion e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertës", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si

provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 8 të DST-së.*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare (2020, 2021, 2022) ku vlera e xhiros minimale për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar të jetë në një vlerë jo më të vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

***Argumentimi:** Kjo vlerë për xhiros vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.*

“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

.... vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;”. Kjo procedurë është mbi kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

2.2.2 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.*

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale.Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2022 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë

Qëndrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të furnizimeve të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave, shërbimeve të realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave, shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenit 40/4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standardin ISO 9001 (ose ekuivalente), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes).

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standardin ISO 27001 (ose ekuivalente) për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standardin ISO 20000-1 (ose ekuivalente) për sistemin e menaxhimit të shërbimit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes).

Argumentimi 2.3.2, 2.3.3 dhe 2.3.4

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ,

“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

- Standardi ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmëria e burimeve të tij, kompetenca/profesionalizmi i punonjësve, procesi i menaxhimit (për furnizim, ofrim shërbimesh dhe për proceset mbështetëse e administrative), planifikimi i cilësisë, garantimi i një procesi cilësor të furnizimit, sigurimi i konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për standardin ISO 9001 ose ekuivalent me të, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës në të gjithë komponentët e saj.

- ISO 27001 është një kuadër standartizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me :

- mirëmbajtjen e sistemit ISMS (Information Security Management System) brenda vetë organizatës së operatorit ekonomik.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive.
- aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambjente sensitive.

Referuar sa më sipër, ky standard i kërkuar, lidhet drejtpërdrejt me zërat përcaktuar në dokumentin e termave të referencës dhe specifikimeve teknike si dhe kontratës në tërësi:

- *Furnizimi i licencës/licencave përkatëse, instalimi dhe konfigurimi i sistemit software të komunikimit në distancë për Policinë Bashkiake, në infrastrukturën e Autoritetit Kontraktor.*

- *Mirëmbajtja e sistemit për një periudhë 24 (njëzet e katër) muaj.*

- *Përfitim i shërbimeve të mirëmbajtjes software të sistemit, përfshirë aksesin në çdo update dhe upgrade software të sistemit në tërësi apo komponentëve të vecantë (patches, SW release evolutions, etj).*

Realizimi i sa më sipër dhe jo vetëm, kërkon ndërhyrje dhe akses në infrastrukturën e Institucionit, kërkon akses përgjatë periudhës së mirëmbajtjes në të dhëna të sistemit i cili do të menaxhojë pajisjet e komunikimit etj, si rrjedhojë certifikimi ISO 27001 është një garanci e nevojshme për Autoritetin Kontraktor për aplikimin e praktikave mbi menaxhimin e risqeve, trajtimin e të dhënave dhe shërbimeve që do të kryhen.

- Standardi ISO 20000-1 përcakton kriteret për planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e qasjes së menaxhimit të shërbimeve që fokusohen në teknologjitë e informacionit.

ISO 20000-1 është një kuadër standardizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomike për: ndjekjen konsistente të shërbimeve objekt kontrate, instalimet konfigurimet, shërbimet e suportit e mirëmbajtjes sistemit të komunikimit në distancë sipas nevojave të AK, bazuar në dokumentin e termave të referencës dhe specifikimet teknike përgjatë afatit të zbatimit të kontratës sipas kërkesave të DST-së.

Kjo çertifikatë ose ekuivalente e saj, siguron Autoritetin Kontraktor që të gjitha shërbimet që kërkohen dhe

që do të realizohen përgjatë kontratës, do të menaxhohen sipas standardeve më të mira të teknologjisë së informacionit.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose distributori të autorizuar për mallrat e ofertuar (zërat 1 dhe 2, tabela “ PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT” e paragrafit 14 të termave të referencës). Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax, email, website, këto të nevojshme për AK në rast verifikimi.

Argumentimi: Referuar nenit 77, pika 1, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës...”

Duke qenë se autoriteti kontraktor, është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për furnizimet e kryera, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion përkatës. Në këtë kontekst, referuar natyrës, volumit dhe objektit të prokurimit, kërkesa për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit të autorizuar për komponentë të rëndësishëm dhe thelbësorë të kontratës, shërben si garanci në çfarëdo rasti anomalie të mundshme përgjatë afatit të ekzekutimit të kontratës, si dhe garanton aktivizimin e shërbimeve të prodhuesit, sic janë ato të suportit dhe mbështetjes teknike e administrative.

Referuar natyrës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dëshmive nga prodhuesi/ distributori i autorizuar për zërat e kërkuar sipas kriterit, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë ose broshurë për produktin që oferton (pajisjet dhe softi i komunikimit në distancë). (Katalogu duhet të përmbajë karakteristikat teknike të cdo artikulli që është objekt i prokurimit me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me specifikimet teknike të DST për përputhshmërinë e tyre). Fleta ose fletët e katalogut/broshurës që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes dhe të software duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 6 germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i ndryshuar) të ndryshuar ku citohet: “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

...
b. *fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose..”*
...”

Kërkesa për paraqitjen e katalogëve, jep mundësinë për kryerjen e verifikimeve për përputhshmërinë e specifikimeve teknike të pajisjeve të ofertuara, paraqitur nga operatorët ekonomikë, në rast se janë në përputhje me specifikimet teknike të hartuara nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.7 Për të garantuar ekzekutimin me sukses të kontratës si dhe për të garantuar shërbimin e mirëmbajtjes, suportit e garancisë përgjatë periudhës së parashikuar sipas termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë punonjës të kualifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

- a) 1 (një) punonjës i certifikuar për *Sisteme komunikimi në distancë* të ofertuar apo ekuivalente me të.
- b) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për sistemet e sigurisë së informacionit.
- c) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Networking

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Certifikata/ Transkriptet përkatëse për specialistët e kërkuar;
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik (emër mbiemër)/profilin (certifikimet) e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B;
- Listëpagesat sipas formularit eSig25 për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 pjesa III, pika B.

Argumentimi: Kërkesa për staf është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Neni 41, pika 4:

“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose çmimet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit

...

a) Kërkesa e autoritetit kontraktor për “1 (një) punonjës që është i certifikuar për *Sisteme komunikimi në distancë të ofertuar apo ekuivalente me të*” është në përpjestim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës objekt prokurimi, konkretisht:

- *Pajisja me një sistem të qendëruar për menaxhimin e pajisjeve të komunikimit.*
- *Furnizimi i licencës/licencave përkatëse, instalimi dhe konfigurimi i sistemit software të komunikimit në distancë për Policinë Bashkiake, në infrastrukturën e Autoritetit Kontraktor.*
- *Trajnimi i stafit teknik dhe përdoruesve fundorë për përdorimin e sistemit*
- *Mirëmbajtja e sistemit për një periudhë 24 (njëzet e katër) muaj.*
- *Garancia e pajisjeve do të jetë 24 (njëzet e katër) muaj.”*

Kërkesa e një punonjësi që është i certifikuar për *Sisteme komunikimi në distancë* të ofertuar apo ekuivalente me të, garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka në stafin e tij punonjës me njohuri të duhura profesionale për realizimin e instalimit të sistemit, cdo konfigurim të nevojshëm për funksionimin e tij, për të garantuar shërbimin e suportit përgjatë periudhës së parashikuar të garancisë së pajisjeve dhe shërbimin e mirëmbajtjes së sistemit sipas Marrëveshjes SLA të përcaktuar në dokumentin e termave të referencës.

Referuar sa më sipër, ky kriter garanton AK për realizimin me sukses dhe në kohë të kontratës në tërësi.

b) Nisur nga natyra e kontratës, duke ditur që komunikimi që do të kryhet nëpërmjet pajisjeve në distancë dhe sistemit i cili do të menaxhojë këto pajisje duhet të jetë i sigurtë dhe konfidencial, prania e një punonjësi të certifikuar për sistemet e sigurisë së informacionit garanton Autoritetin Kontraktor se kontrata do të realizohet duke respektuar dhe zbatuar të gjithë metodat e nevojshme të sigurisë së informacionit për këtë sistem dhe pajisje. Kërkesat e stafit teknik lidhen me nevojën për staf të specializuar për të realizuar detyrat specifike të projektit: dizenjimi teknik, instalimin, monitorimin e burimeve që kërkon në vijimësi sistemi, aksesin në sistem, implementimin e patch-eve dhe upgrade të ndryshëm në sistemin software që garantojnë

sigurinë e sistemit përmes politikave të aksesit së bashku me stafin e AK-së.

Gjithashtu ky punonjës është i domosdoshëm dhe i nevojshëm në mbarëvajtjen e mirëmbajtjes së sistemit për shkak të rëndësisë dhe konfidencialitetit, pasi vend i instalimi i sistemit duhet të jetë në një infrastrukturë me gatishmëri të lartë dhe standarde të sigurisë.

c) Kërkesa për të paktën një punonjës të certifikuar për networking lidhet me një nga detyrat e kërkuara, objekt kontrate, konkretisht:

Furnizimi i licencës/licencave përkatëse, instalimi dhe konfigurimi i sistemit software të komunikimit në distancë për Policinë Bashkiake, në infrastrukturën e Autoritetit Kontraktor...

Duke qenë se një nga detyrat objekt kontrate është instalimi i një sistemi software komunikimi në infrastrukturën fizike të AK-së, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë punonjës të certifikuar me njohuritë e duhura për networking për realizimin e konfigurimeve të nevojshme për këtë zë në infrastrukturën ekzistuese të AK.

Pra ky kriter garanton AK se Operatorit Ekonomik është i certifikuar, ka njohuritë dhe ekspertizën e duhur profesionale për realizimin e kontratës dhe për implementimin e detyrave respektive të prokurimit në infrastrukturën e AK-së.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentim i termave të referencës dhe specifikimeve teknike:

*Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Objektivat kryesore për t'u arritur nëpërmjet këtij projekti janë:

- Mundësimi i aparaturave bashkëkohore të kompjuterizuara, me ndërlihdje, me kanal e frekuencë të veçantë për punonjësit e Policisë Bashkiake.
- Pajisja me një sistem të qendëruar për menaxhimin e tyre.

Rezultati kryesor i kësaj kontrate është furnizimi i pajisjeve të komunikimit në distancë për Policinë Bashkiake (radio dhënëse- marrëse) si dhe furnizimi i një sistemi të qendëruar për të mundësuar funksionimin e menaxhimin e tyre në distancë. Rezultatet e pritshme të këtij projekti përmbledhen si më poshtë:

Rezultatet që duhet të arrihen me implementimin e këtij projekti janë:

- Furnizimi i licensave, instalimi dhe konfigurimi i sistemit të menaxhimit të pajisjeve të komunikimit.
- Furnizimi i aparaturave bashkëkohore me ndërlihdje (radio dhënëse- marrëse), me kanal e frekuencë të veçantë.
- Trajnimi i stafit teknik dhe përdoruesve fundorë për përdorimin e sistemit;
- Mirëmbajtja e sistemit për një periudhë 24 (njëzet e katër) muaj pas implementimit të sistemit, duke filluar nga data e marrjes në dorëzim.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Sistemi i Komunikimit në distancë për Policinë Bashkiake”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

Dokumentat e tenderit

Specifikimet teknike/ termat e referencës

NJËSIA E PROKURIMIT